



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 130, Datë 13.05.2026

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “5GX ENERGY” SH.P.K. PËR KRIJIMIN  
E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS  
DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR  
CENTRALIN FOTOVOLTAIK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 1276/3 prot., datë 11.05.2026 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 5GX ENERGY sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik”,

**Konstatoi se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k.**

- Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024, i ndryshuar, për centralin fotovoltaik me kapacitet 10 MW, në Zonën Kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 111, datë 10.06.2024.

**2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria**

- Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k. me shkresën nr. 1276 prot., datë 27.04.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.

- ERE nëpërmjet e-mailit zyrtar datë 29.04.2026, të protokolluar në vijim me nr. 1276/1 prot., datë 29.04.2026, i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin e pa plotësuar në këtë aplikim dhe në përgjigje, shoqëria me shkresën nr. 1276/2 prot., datë 05.05.2026 ka përcjellë të plotë informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit, përfshirë karakteristikat teknike të centralit fotovoltaik, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, pikën e matjes, etj.

### 3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.
- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se centrali fotovoltaik për të cilin kërkohet regjistrimi, klasifikohet i përshtatshëm për lëshimin e garancive të origjinës sipas nenit 6 të Rregullores dhe tabelës 1.1 të saj.
- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistër si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në kategorinë prodhues dhe tregtar i energjisë elektrike dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k. lidhur me vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**